



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

874 / 20

Datë/Datum.

16.11.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PRISHTINË - PRIŠTINA

PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.874/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Infinit”SH.P.K.,-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Behar Rama B.I & N.T.P Abetare”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me mjete konkretizimi – Pajisje për kabinet të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Malishevës ” me nr. të prokurimit: 62500-20-5915-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Malishevë”, më datën: 13.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Infinit”SH.P.K.,-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me mjete konkretizimi – Pajisje për kabinet të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Malishevës ” me nr. të prokurimit: 62500-20-5915-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- KK-Malishevë,

II.VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me mjete konkretizimi – Pajisje për kabinet të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Malishevës ” me nr. të prokurimit: 62500-20-5915-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Malishevë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Infinit”SH.P.K,-Prishtinë, i aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Infinit”SH.P.K,-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 30.10.2020 me nr. 874/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me mjete konkretizimi – Pajisje për kabinet të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Malishevës ” me nr. të prokurimit: 62500-20-5915-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Malishevë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 59 , 60 , si dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe nenin 39 , 41 të UOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 11.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit ankimor ku thuhet që OE ankues është eliminuar nga AK për arsye që i mungojnë dëshmitë dokumentare të kontratave referencë të natyrës së njëjtë apo të ngjashme për 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë të realizuara, minimumi në vlerë prej 80,000 EUR, Eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe shkresave të dorëzuara e gjen pretendimin si pjesërisht të pabazuar. Arsyetimi i një konstatimi të tillë vijon si më tutje:

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 68 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 39.8 të RRUOPP, gjegjësisht tek shembujt ku jepen në detaje problemet dhe hapat e mëtutjeshëm të veprimit konform dispozitave ligjore. Në rast të mungesës së referencave /certifikatave të pranimit nga lista e kontratave të prezantuara, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë informata sqaruese konform nenit 69. Duhet pasur parasysh që nëse për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatorit ekonomik i lejohej që të demonstrojë gjendjen e vetë ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që autoriteti kontraktues, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm. Për faktin që lista e kontratave përfshin gjithsej 81 kontrata të cilat janë të shënuara nga OE ankues si referencë e që kanë natyrë të ngjashme apo të njëjtë me aktivitetin e tanishëm të prokurimit, mbetet nën përgjegjësinë juridike të Autoritetit Kontraktues që të konstatojë nëse përmbajtja (artikujt në rast të furnizimit) e tyre përkon me fushëveprimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Po ashtu, konform dispozitave ligjore, periudha e vlefshmërisë e kontratave si referencë merret duke pasur parasysh vetëm datën e përfundimit të kontratës. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në RRUOPP, tek pjesa e “Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):”, gjegjësisht pjesa: “Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “.....të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “...në periudhën e shkuar trevjeçare). Në kuptimin e Ligjit shprehja “tri vitet e shkuara” nënkupton: Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”, Një interpretim është dhënë decitivisht edhe nga KRPP, duke theksuar që “nëse gjatë një aktiviteti të prokurimit, një Autoritet Kontraktues në dosje të tenderit ka vendosur kërkesën që Operatorët Ekonomik të kenë kontrata të realizuara në 3 vitet e fundit (nga data e njoftimit për kontratë), kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë, ku për bazë merret data e përfundimit dhe jo e fillimit të kontratës”. Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “FURNIZIM ME MJETE KONKRETIZIMI - PAISJE PËR KABINET TË SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME TË KOMUNËS SË MALISHEVËS” me nr. të prokurimit: “62500-20-5915-1-2-1”, aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Malishevë, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 11.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 11.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje të nderuar ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit, ne kemi kërkuar kontrata të natyrës së të njëjta (jo të ngjashme) siç pretendon Eksperti ku duhet të bëhet dallimi në kë pikë. Siç është e cekur edhe në dosjen e tenderit :

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjtë në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë të realizuara minimumi në vlerë prej; 80,000.00 Euro. ku si dëshmi OE duhet të sjellë :
a) Një Listë e Furnizimeve të natyrës se njëjtë të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar Furnizimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr e prokurimit, kjo listë duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (original), po ashtu duke i bashkangjitur referencat të njëjta ose raportet e pranimit.

Ndërsa OE në fjalë nuk ka arrit të dëshmojë se ka kontrata të përfunduar të natyrës së njëjtë në vlerën e përcaktuar nga AK. Kërkojmë nga Paneli që ta shqyrtoj edhe njëherë lëndën me kujdes dhe ta lenë në fuqi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 15.10.2020.

Ju faleminderit për mirëkuptim, Me respekt, Zyra e Prokurimit Malishevë.

Operatori Ekonomik: "Infinit" SH.P.K-Prishtinë me datë: 13.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbalë mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të

prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, paneli shqyrtues përkunder ekspertit shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit ankimor ku thuhet që OE ankues është eliminuar nga AK për arsye që i mungojnë dëshmitë dokumentare të kontratave referencë të natyrës së njëjtë apo të ngjashme për 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë të realizuara, minimumi në vlerë prej 80,000 EUR, përkundër që eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe shkresave të dorëzuara e gjen pretendimin si pjesërisht të pabazuar. Mirëpo arsyetimi i një konstatimi të tillë nga eksperti shqyrtues duke e nderlidhur konstatimin si vijon:

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 68 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 39.8 të RRUOPP, gjegjësisht tek shembujt ku jepen në detaje problemet dhe hapat e mëtutjeshëm të veprimit konform dispozitave ligjore. Në rast të mungesës së referencave /certifikatave të pranimit nga lista e kontratave të prezantuara, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë informata sqaruese konform nenit 69. Duhet pasur parasysh që nëse për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatorit ekonomik i lejohej që të demonstrojë gjendjen e vetë ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që autoriteti kontraktues, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm. Për faktin që lista e kontratave përfshin gjithsej 81 kontrata të cilat janë të shënuara nga OE ankues si referencë e që kanë natyrë të ngjashme apo të njëjtë me aktivitetin e tanishëm të prokurimit, mbetet nën përgjegjësinë juridike të Autoritetit Kontraktues që të konstatojë nëse përmbajtja (artikujt në rast të furnizimit) e tyre përkon me fushëveprimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Përkundër këtij konstatimi të ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues sqaron se dorëzimi i listës së kontratave duke përfshirë 81 kontrata nga operatori ekonomik ankues nuk nënkupton edhe referencë që kanë natyrë të ngjashme apo të njëjtë me aktivitetin e tanishëm të prokurimit, operatori ekonomik ankues është dashur që të njëjtes listë të kontratave të i'a bashkangjes edhe referencat e njëjta ose raportet e pranimit për ta plotësuar kërkesën decidive të parashtruar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit nga AK, e cila ka qenë si vijon: *"Një Listë e*

Furnizimeve të natyrës së njëjtë të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar Furnizimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr e prokurimit, kjo listë duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal), po ashtu duke i bashkangjitur referencat të njëjta ose raportet e pranimi”.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se, konform dispozitave ligjore, periudha e vlefshmërisë e kontratave si referencë merret duke pasur parasysh vetëm datën e përfundimit të kontratës. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në RRUOPP, tek pjesa e “Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):”, gjegjësisht pjesa: “Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “.....të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “...në periudhën e shkuar trevjeçare). Në kuptimin e Ligjit shprehja “tri vitet e shkuara” nënkupton: Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”, Një interpretim është dhënë decidivisht edhe nga KRPP, duke theksuar që “nëse gjatë një aktiviteti të prokurimit, një Autoritet Kontraktues në dosje të tenderit ka vendosur kërkesën që Operatorët Ekonomik të kenë kontrata të realizuara në 3 vitet e fundit (nga data e njoftimit për kontratë), kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë, ku për bazë merret data e përfundimit dhe jo e fillimit të kontratës”. Duke marrë parasysh se OE ankuese ka dorëzuar listë të kontratave në të cilën ka përfshirë kontrata të natyrave të ndryshme, por nuk ka bashkangjitur referencat të njëjta ose raportet e pranimi për realizim të furnizimeve të njëjta konform kërkesës së AK, si dhe duke pas parasysh edhe përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, paneli shqyrtues konstaton se OE ankues me të drejte është eliminuar nga AK nga ky aktivitet i prokurimit, pasi që nuk i ka plotësuar kërkesat e AK-se të vendosura në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, duke rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik që ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim më të lirë nga të gjithë ofertuesit e përgjegjshëm. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 "KK-Malishevë",
- 1x1 OE - "Infinit"SH.P.K,-Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.